



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 1718/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahim si dhe Kimete Gashi Brajshori- Anëtarë, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me numër 1718/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj konzorciumit Greemed&Medi Health L.L.C, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Pajisje Mjekësore për nevojat e njësive përbërëse të SHSKUK-së, me nr: te prokurimit: 220-25-8216-1-1-1, iniciuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, më: 10.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET**, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të grupit të OE-ve Greemed - Tiran, me nr. unik: K91329017I dhe Medi Health L.L.C - Prishtinë, me nr. unik: 812072677, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Pajisje Mjekësore për nevojat e njësive përbërëse të SHSKUK-së, me nr: te prokurimit: 220-25-8216-1-1-1, iniciuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës.

ARSYETIM

Kërkesa e AK - SHSKUK:

Autoriteti kontraktues pretendon se konzorciumi i operatoreve ekonomik Greemed – Tiran dhe Medi Health L.L.C - Prishtinë, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me Pajisje Mjekësore për nevojat e njësisë përbërëse të SHSKUK-së, me nr: të prokurimit: 220-25-8216-1-1-1, kanë mashtruar/falsifikuar me dëshmit e dorezuara.

Autoriteti kontraktues, përmes kërkesës ka sqaruar se pasi kemi ngritur vendimin B58, disa operatore ekonomik, kanë kërkuar qasje dhe kanë dërguar edhe komunikimet me certifikuesin ECM, ku OE-te kanë dyshuar në certifikatat CE me nr: 1C445621.ADFYH77, 0A150331.AMEUU83 dhe 0A150331.AMEUU12. lidhur me këtë pretendim të operatoreve ekonomik si autoritet kontraktues kemi kërkuar me shkrim nga trupa certifikuese ECM, lidhur me autenticitetin dhe origjinalitetin e certifikatave CE të larteshenuara.

Në përgjigje trupa certifikuese ECM, kanë deklaruar se certifikatat me nr: 1C445621.ADFYH77, 0A150331.AMEUU83 dhe 0A150331.AMEUU12, janë false dhe se nuk kemi leshuar certifikat për Ari Medical Technology Co (prodhuesi Kinez me të cilin ka ofertuar konzorciumi Greemed – Tiran dhe Medi Health L.L.C – Prishtinë).

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna më lartë, autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 të LPP-se me pretendimin se OE-te Greemed – Tiran dhe Medi Health L.L.C - Prishtinë, ka paraqitur dokumente me përmbajtje të rreme ose të falsifikuar, njëherit AK-ja, kërkesës për marrjen e masave të bashkangjitur provat/verifikimet e bera.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatoreve Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 21.11.2025, të AK - SHSKUK, e ka njoftuar konzorciumin e OE-ve Greemed – Tiran dhe Medi Health L.L.C - Prishtinë, me qëllim që operatorët ekonomik në fjalë të japin faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Medi Health L.L.C, në përgjigje të kërkesës së OSHP-se ka dhënë faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se duke e kundërshtuar në teresi pretendimet e AK-se dhe njëherit ka kërkuar që kërkesa e AK-SHSHKUK, të refuzohet në teresi si e pa bazuar. Në vazhdim ka sqaruar se në këtë aktivitet të prokurimit, kemi ofertuar si konzorcium dhe në si operator ekonomik jemi anëtar të konzorciumit dhe njëherit ka deklaruar se autorizimi nga prodhuesi Kinez Ari Medical Technology Co është leshuar për liderin e konzorciumit Greemed – Tiran dhe certifikatat janë dërguar poashtu tek OE Greemed. Sipas OE Medi Health L.L.C, të gjitha komunikimet me prodhuesin Kinez janë bërë nga OE Greemed dhe se e gjithë procedura në këtë aktivitet të prokurimit është udhëhequr nga lideri OE Greemed.

OE Greemed në përgjigje të kërkesës së OSHP-se ka dhënë faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se duke e kundërshtuar në teresi pretendimet e AK-se dhe njëherit ka kërkuar që kërkesa e AK-SHSHKUK, të refuzohet në teresi si e pa bazuar.

Ne sqarimin e tij, OE Greemed, ka sqaruar certifikatat jane kerkuar nga ne si operatore ekonomik, nga prodhuesi Ari Medical Technology Co – Kine.

Pas dyshimeve lidhur me vertetsine e certifikatave, ne kemi kerkuar sqarim me shkrim me daten: 04.11.2025, nga prodhuesi dhe ne pergjigje prodhuesi Ari Medical, ka deklaruar se certifikatat i ka pranuar nga nje agjensi vendore dhe madje na ka rekomanduar terheqjen duke shprehur edhe keqardhjen lidhur me kete ceshtje.

Pas rrethanave te reja te krijuara, konkretisht lidhur me sqarimin e dhene me lart nga prodhuesi Ari Medical, ne si operatore ekonomik, me daten: 05.11.2025, kemi planifikuar qe te terhiqemi nga ky aktivitet i prokurimit, mirepo pasi qe veq ishim te eliminuar sipas letres standarde te dates: 30.10.2025, kerkesen per terheqje nuk e kemi derguar te AK-ja.

Ne fund, te sqarimit tij OE Greemed, ka deklaruar se si lideri i konzorciumit nuk kemi pasur asnje dijeni, pakujdesi apo qellim mashtrues gjate dorezimit te dokumentacionit per kete aktivitet te prokurimit dhe sipas OE Greemed, kete e verteton fakti qe prodhuesi Ari Medical, e ka pranuar qe certifikatat jane derguar ne ate form nga vet prodhuesi.

OE Greemed, pergjigjes se derguar ne OSHP, i ka bashkangjitur te gjitha komunikimet elektronike si prova.

Vlerësimi i pretendimeve te autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Greemed&Medi Health L.L.C:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, dhe arsyeshmërisë së dhënë nga Operoret ekonomik, provave te ofruara nga AK – SHSKUK, diskutimeve dhe shoshitjes së provave, fillimisht Paneli shqyrtues vlerëson se anetari i konzorciumit OE Medi Health L.L.C, perjashtohet nga kerkesa e autoriteit kontraktues per marrjen e masave sipas nenit 99 te LPP-se, per faktin se autorizimi i prodhuesit dhe certifikatat CE jane derguar per OE Greemed dhe njeherit kete fakt e pranojne te dy operoret ekonomik, qe deshmit e lartpermendura jane kerkuar nga prodhuesi, nga OE Greemed - Tiran.

Sa i perket, OE Greemed, paneli shqyrtues vlereson se pas analizimit te shkresave te lendes, ku OSHP ka pranuar si prove konfirmimin e trupes certifikuese ECM se certifikatat CE jane false dhe njeherit OE Greemed, ka dorezuar si prova komunikimet elektronike (te dates: 05 dhe 06 Nentor 2025) ku verehet qarte se certifikatat jane derguar ne ate format nga prodhuesi Ari Medical. Pra, ne rastin konkret pergjegjsine per certifikatat CE e merr prodhuesi Ari Medical – Kine.

Nga administrimi i provave rezulton se OE Greemed, nuk ka nderhyre ne dëshmit e dorëzuara ne këtë aktivitet te prokurimit. Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99

të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka dorëzuar prova që OE Greemed ka tentuar të mashtrojë/falsifikojë me deshmim të dorëzuara.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nënin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – SHSKUK

1x1 OE Greemed&Medi Health

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

